

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Nr. 928/46 Prot.
Datë 01.08 2022

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Nr. 14819/A Prot.
Datë 3.8. 2022

UDHËZIM
Nr. 14, datë 01.08.2022

**PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 11.02.2022 “PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6 dhe nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të pikës 5, të VKM nr. 101, datë 9.2.2022, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 11.02.2022 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun 1, “Përdorimi i fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, shtohen masat 7/1 dhe 7/2 me këtë përmbajtje:

“7/1. Mbështetje për kultivimin e grurit, për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 HA, në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për HA.

7/2. Mbështetje me 40 (dyzet) lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit për furnizimet nga data 1 korrik 2022 deri 31 dhjetor 2022.”.

2. Në kreun IV, “Aplikimi”, në titull, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Aplikimet për masën 7/1 do të bëhen on-line nga data 1 shtator 2022 ora 8.00 deri në datën 23 shtator 2022, ora 22.00. Dokumentacioni që provon pronësinë dhe/ose përdorimin e tokës dhe dokumenti i bankës për numrin e llogarisë mund të dorëzohet në procesin e aplikimit”.

3. Në kreun VI, "Kriteret specifike dhe dokumentacioni i nevojshëm për masat mbështetëse direkte 1, 3-7" bëhen shtesat me përmbajtje si vijon:

- a. Në fund të titullit pas shprehjes "3-7", shtohet togfjalëshi "7/1 dhe 7/2".
- b. Pas "MASA 7. Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt." shtohen Masa 7/1 dhe Masa 7/2 me përmbajtje si vijon:

"Masa 7/1. Mbështetje për kultivimin e grurit, për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 HA, ne vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për HA.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individual, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;
- b. Toka të jetë në pronësi ose në përdorim (qira, huapërdorje, etj);
- c. Fatura e fiskalizuar për blerjen e farës dhe plehrave kimike.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti pas përfshirjes në Listën e subjekteve të kualifikuara

a. Dokumentacioni i pronësisë së tokës ose përdorimit:

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatë pronësie, hartë treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;
- Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) dhe fragmenti i hartës kadastrale të vërtetuar nga DAMT ose Njësia Administrative ku ndodhet ngastra, ose planvendosjen e parcelës/ave të mbjella me informacionin e dhënë në Aneksin 4 të udhëzimit.

Kur aplikuesi e përdor tokën me qira ose formë tjetër paraqet:

- Kontratë qiraje ose dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve. Në rast se kontrata ose dokumenti janë të panoterizuara duhet të jetë i konfirmuar nga Njësia Administrative dhe të përfshijë dokument identifikimi të palëve.

Dokumentacioni që provon përdorimin (kontratë qiraje, huapërdorje, etj) duhet të përfshijë si afat përdorimi muajin korrik 2023.

b. Në rastin e aplikimit nga një anëtar i familjes bujqësore, i ndryshëm nga mbajtësi i AMTP-së paraqitet dakordësia e anëtarëve të tjerë të familjes bujqësore sipas aneksit 12 të udhëzimit. Kur pronësia provohet me certifikatë pronësie është e nevojshme dakordësia nga bashkëpronarët që rezultojnë në certifikatë, sipas aneksit 12 të udhëzimit.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar ne momentin e verifikimit në terren

- a. Faturë për blerjen e farës së grurit dhe plehrave kimike.
- b. Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit. Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit.
- c. Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t'i dorëzojë pranë Agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem.

iv. Në rast se një parashikim në këtë kre vjen në kundërshtim me parashikime të tjera të udhëzimit, përparësi kanë parashikimet në këtë kre.

Masa 7/2 Mbështetje me 40 (dyzetë) lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit, për furnizimet nga data 1 korrik 2022 deri 31 dhjetor 2022.

i. Kritere specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Subjekte të pajisur me statusin Pritës të Regjistruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për furnizime me karburant në Shqipëri.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti:

- a. Kërkesë me shkrim për pagesë drejtuar AZHBR-së,
- b. Dokumenti i lëshuar nga banka e nivelit të dytë që identifikon numërin e llogarisë së aplikuesit, ku do të bëhet pagesa, në origjinal (paraqitet vetëm në kërkesën e parë),
- c. Deklarata doganore IM4 (e cila ka vulë elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave), e noterizuar ose e njehsuar me origjinalin,
- ç. Fatura e shitjes dhe kuponi fiskal të lëshuar nga magazine doganore ose zonë e lirë, fotokopje.

Dokumentacioni dorëzohet ose dërgohet me postë në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose dorëzohet në AGROPIKA.

iii. AZHBR nuk kryen pagesë në mungesë të njërit prej dokumenteve ose të paraqitura jo në përputhje me kërkesat e paragrafit *ii.* më sipër.

Pagesat do të kryhen sipas radhës së paraqitjes së dokumentacionit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda datës 15 gusht 2022, dërgon në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural listën e subjekteve anije peshkimi të pajisura me status Pritës të Regjistruar.

4. Në kreun VII, “Procedurat që do të ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr.1, 3-7”, bëhen këto shtesa:
 - a. Në pikën 1, në fund shtohet paragrafi:
“Për masën 7/1 aplikimi bëhet për kultivimin e grurit të mbjellë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Pagesa bëhet pas kontrollit në terren për verifikimin e sipërfaqes së mbjellë.”
 - b. Në pikën 2, në fund të fjalisë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“Për masën 7/1, pas përfundimit të aplikimeve, renditja do të bëhet nga sipërfaqja më e madhe tek sipërfaqja më e vogël. Në rast të aplikimeve me të njëjtën sipërfaqe renditja do të bëhet sipas kohës së aplikimit.”
 - c. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:
“Për kryerjen e kontrolleve në terren angazhohen dhe punonjësit e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore.”
5. Në kreun XI, pika 18, pas togfjalëshit “Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës” shtohet dhe “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

FRIDA KRIFCA

Në mungesë dhe me urdhër

ZËVENDËSMINISTËR

DHIMITËR KOTI



**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

DELINA IBRAHIMAJ

